

## E DIELA E SHEN ATERVE

## THIRRTORET, T. T. II

*Këndohen dhjetë, domethënë katër të Tingëllit, tri të Shes-tjes, dhe tri të Shën Atërve:*

## PAS IKOS TU EFRATHA, T. II.

Zoti u-ngjit në qjell, dhe ndënji më të djathtë, mi

fronin pranë Atit, dhe Engjëjtë e pritnë, me bujë dhe me brohori. **(2 herë)**

Engjëjtë me lavdi, kur panë që u-ngjite, i hipur përmi retë, çuditëshin dhe thoshnin: Lavdi më ty o Zoti Krisht.

Qanin me kuj' e vaj, dishepujtë kur panë, që flutur-sipër, dhe thoshnin të përlotur: Jetimë mos na ler mi dhe.

Brënda në shtatë dit, e bëri Zoti botën, dhe ju në shtatë mbledhje, na regulluat fenë, o Atër të Sinodeve.

Një Perëndi dhe Zot, të ndarë në tre veta, të njëshmë nga substanca, dhe një Trini lëçittë, o Atër të Sinodeve.

Krishtin si Perëndi, dhe Bir të Perëndisë, dhe Fjalë të panisme, na çfaqhtë dhe na çpalltë, o Atër të Sinodeve.

LAVDI. Shtyptë çdo heresi, dhe ujqërit që çanin, kopen' e Jesu Krishtit, i çkatërruat fare, o Atër të Sinodeve.

TANI. Cili s' të lumëron tani . . . (*Shiko Kremtoren, f.110-111*)

## PASVARGJET, T.T. II

*Këndohen katër të Tingëllit Tërthor II, dhe Lavdia e Shën Atërve më Tingëllin II pas IKOS TU EFRATHA:*

LAVDI. Muartë frymësim, prej Shpirtit edhe shkruat, Simbolin e Nikesë, për Kishën Orthodokse, o Atër të Sinodeve.

TANI. Virgjërën Shën Mari, që lindi Jesu Krishtin, Hyjlindëse dhe Nënë, të Perëndis' e çfaqhtë, o Atër të Sinodeve.

*Pas Trishenjtit, këndohen Përlëshoret e Tingëllit Tërthor II, e Shën Atërve, dhe e Shestjes. Në Shërbesën e Mëngjezit thuhet Ndënjësoret, Dëgjimi, dhe Shkallesat e Tingëllit Tërthor II.*

#### SHKURTORJA, T.T. IV.

Lëçitjet e Apostujve, dhe dogmat e Atërve, e forcuan besën e njëshme të Kishës, e cila me këmishën e së vërtetës, të endur prej theollogjisë qjellore, lavdëron misterin e math të Orthodoxsisë.

#### SHTEPIA

Kisha e Perëndisë lëçit, edhe thërret me zë të lartë: Ay, që ka etje, le të vinjë, dhe le të pinjë verën e urtësisë, dhe verën e besës që ta njohë Perëndinë e vërtetë. Ata, që kungojnë me këtë verë, do të shtohen, edhe do ta lavdërojnë misterin e math të Orthodoxsisë.

#### SINAKSARI

Gjithë sot, të Dielën e shtattë pas Pashkës së Madhe, kujtojmë të tre qint e tetëmbëdhjetë Atërit e Shenjtë, që muarnë pjesë në Sinodin e Parë Ekumenik të Nikesë.

Me nërmjetimet e Shën Atërve tanë, o Perëndia ynë, mëshirona. Amin.

#### ZBRITESORET, T. IV.

#### THIO KALIFTHIS

- I. Mjegull e mbuloj bëlbëcakun në malin  
Kur e proklamoj ligjën e Perëndisë;  
Se e hodhi tej errësirën e mëndjes,  
E pa të Lartin dhe prej Shpirtit i ndriçuar  
Mori dijën dyke lavdëruar Zotin.

- III. Lithmën e çliroj të beronjës pa foshnjë,  
Talljen e pëllores me fëmijë shumë  
E pushoj një herë Profetesha Anna  
Me të falura me frymë të dërmuar  
Përpara Perëndisë Zotit të mëshirës.
- IV. Mbret i mbretërve dhe Bir i vetëmlindur,  
Fjal' e Perëndi prej Atit të panismë  
Shpirtin e bashkëfuqishm' e të pavdekur  
U dërgove Apostujve për lëçitjen  
Dhe ata këndonin: Zot lavdi më ty.
- V. Ndjes' e paqësimit për faje dhe mëkata  
Prisni prej Shpirtit vesën e frymëzjarhtë  
Bij të Kishës me fytyrë të ndriçuar,  
Se tani na doli ligja nga Siona,  
Hir i Shpirtit Shenjt me gjuhëra prej zjarri.
- VI. Që të na shpëtosh e të na ndjesh mëkatat  
Linde përmi dhe si Zot prej Virgjëreshës  
Dhe si Profetin Shën Jona prej mushkërive  
Të balenës e shpëton edhe njerinë  
Të rrëzuar dhe të mbytur nga mëkatat.
- VII. Krisi me një zë një këngë me strumenta  
Për adhurimin e statujës njerëzore;  
Po Ngushëllimtari na ndriçon me hir  
Edhe na fton të themi: O Trini e vetëm,  
E shenjtë, e panisme, e bekuar je.
- VIII. Çdo zinxhir e zgjith edhe çdo flag' e shuan  
I tridritëshmi simbol i Perëndisë.  
Hymnojnë Djemat dhe e bekojnë Zotin,  
Shpëtimtarin Krijetar si mirëbërës  
Gjithë veprat që i ka krijuar vetë.

*Pastaj këndohet Ungjëlli Mëngjesor I (shiko Kremtoren, f. 141-2.)*

IX. *Engjëjtë, kur panë Shestjen e Zotit, çuditëshin dhe shtangëshin, qysh me lavdi fluturonte, që prej dheut më të lartat.*

O Hyjilindëse Virgjëreshë dhe Nënë,  
Gjuha më e mprehtë dhe oratorike  
Nukë munt të të këndonjë pas vlerës,  
Dhe vertikohet mëndja për lindjen tënde;  
Pra me një zë të gjithë të lavdërojmë.

#### DERGIMESORET, T. III PAS EPESKEPSATO IMAS

O Shën Atër të Kishëve, u çpalltë dogmat popujve,  
dhe heretikët besëliq, i çkatërruat plotërisht; u faltë pra besnikëve, në qjellin Mbretërinë, Parajsën e Engjëjve.

Apostujtë çuditëshin, kur fluturove lart në qjeil,  
edhe ndënje përmi fron, nga an' e djatht' e Atit tënt;  
Pra edhe ne o Zoti Krisht, vëndosna për së shpejti, në gas të Shenjtorëve.

Nërmjetoni tok për ne, Shën Atër të Sinodeve, dhe ti o Zonjë Shën Mari, përkrahna pranë Birit tënt; nga çdo dënim shpëtonani, na falni Mbretërinë, qjellore të Zotit Krisht.

#### LAVDERIMET, T.T. II.

*Këndohen tetë, domethënë katër të Tingëllit edhe katër të Shën Atërve me Lavdinë e Shën Atërve. (Shiko Kremtoren, f. 253-4). Në Hyrjen këndohen Përlëshoret e Tingëllit, e Shën Atërve, e Shestjes, edhe Shkurtorja e Shestjes.*

#### PERLESHORJA E SHEN ATERVE, T.T. IV.

I përnilavdëruar je o Krisht Perëndi dhe Zot, që dërgove përmi dhe, Atërit tanë të Shenjtë dhe i ndrite, dhe me ata na shpure në besën e drejtë, dhe na tregove shpëtimin. O mëshirëplot lavdi më ty.

#### SHKURTORJA, T.T. IV.

Passi e mbarove punën për ne mi dhenë, dhe si i pajtove njerëzit me Perëndinë, fluturove në qjellin o Krisht Perëndi dhe Zot, po s' u-ndave prej dishepujve, se qëndron gjithënjë me ne, se u the me mall besnikëve: Ja unë jam me ju, dhe asnjë kundër jush.

*Hymni Trishenjtor, pastaj:*

#### APOSTULLI

I bekuar je, o Zot, o Perëndi i Atërve tanë.

Se je i drejtë më të gjitha sa na bëre.

Këndimi prej Akteve të Apostujve.

Më ato ditë, Pali vëndosi të lundrëzonte me anën e Efesës që të mos humbiste kohë në Asi; se nxitohet, po të muntte, të ndodhej në Jerusalem ditën e Rushajeve. Edhe dërgoj fjalë prej Miletës në Efesë, edhe thirri pleqtë e Kishës. Edhe kur i arthnë, u tha: "Kini kujdes për veten tuaj dhe për tërë grigjën, mi të cilën Shpirti i Shenjtë ju ka vënë peshkopë, që ta ruani Kishën e Perëndisë, të cilën e ka fituar me gjakun e vetë. Se unë e di që, pas ikjes sime, do të hyjnë në mes tuaj ujqër të këqinj, të cilët nukë do ta kursejnë grigjën. Edhe nga mezi juaj do të ngrihen disa njerës, të cilët do të flasin gjëra të shtrëmbëra që t'i heqin dishepujtë pas vetes së

tyre. Përandaj vigjëlloni, edhe kujtoni që tre vjete me radhë nuk pushova së këshilluari cilindo me lote nat' e ditë. Edhe tani, o vëllezër, ju le në duartë e Perëndisë dhe fjalës së hirit të tij, i cili munt tju ndërtonjë, dhe tju japë një trashëgim në mes të gjithë të shenjtëruarve. Nukë kam lakmuar arin, a argjëndin, a petkat e askujt. Edhe ju vetë e dini se për nevojat e mia dhe të shokëve të mi kam shërbyer me këto duartë e mia. Jua tregova të gjitha, se kështu duhet të punoni, edhe t'i përkrahni të pafuqishmët, edhe t'i kujtoni fjalët e Zotit Jesu, i cili tha: "Eshtë gjë më e lumur të japësh se sa të marrësh." Edhe passi tha këto fjalë, ra më gjunjë, edhe u-fal me të gjithë ata.

#### UNJILLI PAS JOANIT

Më atë kohë, Jesuj i ngriti sytë në qjell, edhe tha: "Atë, ardhni ora, lavdëroje Birin që të të lavdëronjë edhe Biri, se i ke dhënë fuqi mi të gjithë njerëzit, që tu dhuronjë jetën e ameshuar atyre, që i ke dhënë pas. Edhe jeta e ameshuar është kjo, që të njohin ty, të vetëmin Perëndi të vërtetë dhe Jesu Krishtin, që ke dërguar. Unë të lavdërova mi dhenë; e mbarova punën, që më urdhërova të bënj. Edhe tani lavdëro-më ti, o Atë, pranë teje me lavdinë, që kisha me ty përpara se të krijohej bota. Ua çfaqta emrin tënt njerësve, që më ke dhënë prej botës. Ishin të tutë, edhe m'i ke dhënë mua, edhe ta kanë ruajtur fjalën. Tani e kanë kupëtuar se të gjitha ato, që më ke dhënë, janë prej teje; se ua dhashë fjalët, që më ke thënë; dhe ata i muarnë, dhe e kupëtuan me të vërtetë që unë dolla prej teje, dhe e besuan që ti më ke dërguar. Për këta po të lutem; nukë të lutem për botën, po për ata, që më ke dhënë, se janë të tutë; edhe të gjitha të miat janë të tuat, edhe të tuat janë të miat,

edhe jam lavdëruar me ato. Edhe tani unë nukë jam më në botë, se vinj pranë teje, po këta mbeten në botë. Atë i Shenjtë, ruaji më emrin tënt ata, që më ke dhënë, që të jenë një si ne. Kur isha me ata në botë, i ruanja unë më emrin tënt. I kam ruajtur ata, që më ke dhënë, dhe asnjë prej atyre nukë humbi përveç të birit të humbjes, që të mbushej Shkriptura. Edhe tani vinj pranë teje, dhe këto i flas në botë që ta kenë të plottë gëzimin tim.

*Pastaj vazhdon Meshja e zakonitë e Shën Joan Gojartit, po në vënt të "Pamë Dritën" këndohet Përlëshorja e Shestjes.*